



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 585/9 prot.

Tiranë, më 03.12.2020

VENDIM
Nr.167, datë 03.12.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 119, DATË 14.10.2020

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 119, datë 14.10.2020, të Komisionerit, *“Për përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së marrëdhënies së punësimit të punonjësës *****, në Njësinë Administrative Shëngjin, të Bashkisë Lezhë dhe masat për rregullimin e gjendjes”*.

KONSTATOVA SE:

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 585 prot., datë 6.7.2020, punonjësja ***** ka kërkuar rishikimin e Vendimit Nr. 93, datë 15.10.2019, të Komisionerit, me pretendimin se gabimisht marrëdhënia e saj e punës është konsideruar e paligjshme, pasi emërimi i saj në ish Komunën Shëngjin (sot Njësia Administrative Shëngjin) është para fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe se statusin e nëpunësit civil ajo e ka përfituar për shkak të veprimit të këtij ligji.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Lezhë të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast (duke përfshirë edhe dokumentacionin financiar të pagesës së nëpunësve)

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr.119, datë 14.10.2020, të Komisionerit, *“Për përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së marrëdhënies së punësimit të punonjësës *****, në Njësinë Administrative Shëngjin, të Bashkisë Lezhë dhe masat për rregullimin e gjendjes”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Lezhë, me shkresën nr. 18637/1 prot., datë 30.10.2020, *“Në lidhje me zbatimin e Vendimit nr. 119, datë 14.10.2020, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Lezhë, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, me aktin nr. 19134 prot., datë 22.10.2020, ***** është deklaruar *“nëpunëse civile”* në pozicionin *“Specialist Finance”*, Njësia Administrative Shëngjin, pranë Bashkisë Lezhë dhe në dosjen e saj të personelit janë materializuar të gjitha aktet që kanë të bëjnë me ecurinë në karrierë të kësaj nëpunëseje.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 119, datë 14.10.2020, të Komisionerit, *“Për përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së marrëdhënies së punësimit të punonjës ***** në Njësine Administrative Shëngjin, të Bashkisë Lezhë dhe masat për rregullimin e gjendjes”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Lezhë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 119, datë 14.10.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Lezhë dhe nëpunësja *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Konceptoi: S. Ndoka

Pranoi: E. Hebibasi

Miratoi: A. Basha